

Rregullore  
Për  
“Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së  
kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e  
shërbimeve të komunikimeve elektronike  
publike”<sup>1</sup>

Dokument për  
Këshillim Publik<sup>2</sup>

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.1, datë 19.03.2025)

---

<sup>1</sup> Kjo Rregullore është përafuar plotësisht me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243 e datës 17 dhjetor 2019 që përcakton modelin për përmbledhjen e kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun në përputhje me Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. CELEX\_32019R2243, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 336, datë 17.12.2019, f. 274-280.

<sup>2</sup> Shpjegime dhe sqarime në lidhje me dokumentin dhe procesin e këshillimit publik për palët e interesuara janë dhënë në Shtojcën 1, në fund të dokumentit të draft-Rregullores.

## **Neni 1**

### **Qëllimi, Objekti dhe Fusha e Veprimit**

Kjo Rregulloreje përcakton modelin e përmbledhjes së kontratës që ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, duhet të plotësojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve fundorë në mënyrën e duhur me informacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të pikave 5 dhe 6 të Nenit 141 të Ligjit Nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Të drejtën për t’u pajisur me dokumentin e Përmbledhjes së Kontratës e kanë përdoruesit fundorë të kategorisë Konsumatorë, si dhe përdoruesit fundorë të kategorisë jo-konsumator (biznes) që janë mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse, përveç rasteve kur këta të fundit japin pëlqimin e shprehur se heqin dorë nga kjo e drejtë.

## **Neni 2**

### **Përkufizime**

Përveç sa parashikohet nga Ligji 54/2024, dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **Përmbledhje e kontratës:** është dokumenti me infomacionin përmbledhës parakontraktor i vënë në dispozicion të përdoruesit fundor nga ofruesi i shërbimit sipas kërkesave të pikave 5 dhe 6 të Nenit 141 të Ligjit 54/2024 dhe sipas modelit dhe në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje.
2. **Përdorues fundorë të kategorisë mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse:** janë ndërmarrjet ose organizatat jofitimprurëse të përcaktuara/klasifikuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi dhe që kërkojnë të lidhin ose lidhin kontratë pajtimi në emër të ndërmarrjes ose organizatës si përdorues fundor i kategorisë jo-konsumator (Biznes) me jo më shumë se 49 përdorues fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë.

## **Neni 3**

### **Modeli i përmbledhjes së kontratës**

Ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, në zbatimin e detyrimeve të pikave 5 dhe 6 të Nenit 141 të Ligjit 54/2024 për vënien në dispozicion të konsumatorit të përmbledhjes së kontratës, duhet të përdorin modelin e përmbledhjes së kontratës në Aneksin 1, në përputhje me udhëzimet për plotësimin e modelit në Aneksin 2 të kësaj Rregulloreje.

## **Neni 4**

### **Prezantimi i përmbajtjes**

1. Përmbledhja e kontratës, me përjashtim të rasteve objektivisht të justifikuara, nuk duhet të tejkalojë ekuivalentin e 1 (një) faqe në format A4 të shkruar në një anë të vetme kur printohet. Në rastet kur shërbimet apo shërbimet dhe pajisjet fundore, që përmbajnë të paktën një shërbim të aksesit në internet ose shërbim të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra të disponueshme për publikun, integrohen si paketë në një kontratë të vetme, përmbledhja e kontratës, me përjashtim të rasteve objektivisht të justifikuara, nuk duhet të tejkalojë ekuivalentin e 3 (tre) faqeve në format A4 të shkruar në një anë të vetme kur printohet.
2. Informacioni i përfshirë në përmbledhjen e kontratës duhet të paraqitet në formatin vertikal (Portret) dhe në përputhje me rendin e titujve të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje. Lloji i shkrimit të përdorur duhet të jetë i tillë që teksti të jetë lehtësisht i lexueshëm. Madhësia e shkrimit duhet të jetë të paktën 10 pikë. Në raste objektivisht të justifikuara madhësia e shkrimit mund të reduktohet; në të tilla raste duhet të ofrohet mundësia që përmbledhja e kontratës të zmadhohet me mjete elektronike ose me kërkesë të merret në format me madhësi shkrimi jo më pak se 10 pikë.
3. Përmbajtja e përmbledhjes së kontratës duhet të jetë lehtësisht e lexueshme me kontrast të mjaftueshëm midis llojit të shkrimit të përdorur dhe sfondit të dokumentit, sidomos në rastin e përdorimit të ngjyrave. Objektet vizuale, nuk duhet të vendosen mbi tekstin e përmbledhjes së kontratës.
4. Përmbledhja e kontratës duhet të hartohet në gjuhë që është lehtësisht e lexueshme dhe kuptueshme për konsumatorët. Përmbledhja e kontratës duhet të fokusohet në informacionin kyç që konsumatori ka nevojë për të krahasuar ofertat dhe të kryejë një vendim-marrje të mirëinformuar.
5. Titujt duhet të jenë qartësisht të dallueshëm nga teksti.

## **Neni 5**

### **Hyrja në fuqi dhe zbatimi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datë 20.12.2025.

## **Aneks 1: Modeli i Përmbledhjes së Kontratës**

[Emri i shërbimit]

[Ofruesi / Logo e ofruesit]

[Detaje te kontaktit]

### Përmbledhje e kontratës

- Kjo përmbledhje e kontratës përmban elementët kryesorë të kësaj oferte të shërbimit sipas kërkesave të Ligjit 54/2024<sup>1</sup>
- Ky informacion lehtëson krahasimin midis ofertave të shërbimit.
- Informacion i plotë për shërbimin jepet në dokumenta të tjerë.

<b>Shërbimi/shërbimet dhe pajisje fundore</b>	
[...]	
<i>Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarrëveshjeve</i>	
[...]	
<b>Çmimi</b>	
[...]	
<b>Kohëzgjatja, rinovimi dhe përfundimi</b>	
[...]	
<b>Funksionalitete të shërbimit për përdoruesit me aftësi të kufizuara</b>	
[...]	
<i>Informacione të tjera të rëndësishme</i>	
[...]	

<sup>1</sup> Pika 5 e Nenit 141 të Ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

## **Aneks 2: Udhëzime për plotësimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës**

Emri ose marka i/e shërbimit (shërbimeve) të komunikimit elektronik të ofruar vendoset direkt mbi titullin "Përmbledhje e kontratës".

Emri i ofruesit duhet të vendoset menjëherë pas emrit të shërbimit (shërbimeve) të komunikimit elektronik. Ofruesi mund të vendosë logon e tij në të djathtë të titullit "Përmbledhje e kontratës".

Tre fjalitë/frazat hyrëse janë pjesë integrale e përmbledhjes së kontratës dhe nuk duhet të ndryshohen.

Emri, adresa dhe detaje të kontaktit të ofruesit të shërbimit dhe, detajet kontaktit për ankesa të mundshme nëse këto detaje kontakti janë të ndryshme nga ato për informacion, duhet të përfshihen poshtë emrit të ofruesit të shërbimit. Përmbledhja e kontratës duhet të përmbajë dhe datën e nxjerrjes së dokumentit.

Në rastet kur kontrata nuk përfshin ofrim të pajisjeve fundore, referenca 'pajisjet fundore' në titullin "Shërbimi/shërbimet dhe pajisjet fundore" fshihet ose tregohet si jo i zbatueshëm. Në rastet kur kontrata nuk përfshin shërbim të aksesit në internet, seksioni "*Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarrëveshjeve*" fshihet ose tregohet si jo i zbatueshëm. Në rastet kur nuk jepet ndonjë informacion tjetër, seksioni "Informacion tjetër i rëndësishëm" fshihet ose tregohet si jo i zbatueshëm.

Teksti me shkronja korsike (italic) në Pjesën A tregon se këta tituj të cituar dhe informacionet e lidhura nuk janë të detyrueshme në të gjitha rrethanat. Kllapat katrore të përdorura në Pjesën A zëvendësohen me informacionin e kërkuar.

### **Seksioni "Shërbimi/shërbimet dhe pajisje fundore"**

Në këtë seksion përfshihet përshkrimi i karakteristikave kryesore të shërbimit (shërbimeve) të komunikimit elektronik, për shembull, telefoni fikse, telefoni zanore celulare, akses në internet celular, akses në internet nga rrjetet fikse, shërbimi i transmetimit TV (si TV Kabllor apo IPTV) ose shërbim i komunikimit ndërpersonal të pavaruar nga numrat. Për ofertat nëpërmjet paketave të shërbimeve sipas nenit 147 të Ligjit 54/2024 përfshihet dhe përshkrim për llojin e pajisjes fundore dhe shërbimeve pjesë e paketës, të tilla si paketat TV, video me kërkesë (video-on-demand) ose shërbime të mediave të tjera sipas rastit. Për shërbimet e transmetimit që përfshijnë transmetime TV dhe për paketat që përfshijnë shërbime të tilla, përfshihet informacion për llojin e paketës TV të ofruar nëse nuk është e mundur të përfshihen të gjitha kanalet TV të përfshira në paketë. Për paketat, shërbimet do të shënohen sipas rendit të përmendur në këtë paragraf. Përshkrimi duhet të përfshijë, kur është e aplikueshme, volumin ose sasinë e thirrjeve, mesazheve dhe të dhënave të përfshira si dhe politikën e përdorimit të drejtë në roaming të aplikuar nga ofruesi i shërbimit.

### **Seksioni "Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike për ankesa/zgjidhje mosmarrëveshje"**

Në raset kur shërbimi përfshin aksesin në internet, duhet të përfshihet një përmbledhje e informacionit të kërkuar sipas shkronjave “ç” dhe “d” të pikës 1 të Nenit 178 të Ligjit 54/2024. Për shërbimin aksesit në internet në rrjet fiks përfshihet shpejtësia minimale, normalisht e disponueshme dhe maksimale e shkarkimit dhe ngarkimit, dhe në rastin e rrjeteve celulare përfshihet shpejtësia maksimale e vlerësuar e shkarkimit dhe ngarkimit të shërbimit të aksesit në internet. Në këtë seksion përfshihet dhe një përshkrim i mjeteve juridike të disponueshme për konsumatorin në përputhje me Ligjin 54/2024 në rast të mospërputhjeve të vazhdueshme ose rregullisht të përsëritura midis performancës aktuale të shërbimit të aksesit në internet në lidhje me shpejtësinë ose parametrat e tjerë të cilësisë së shërbimit dhe performancës së deklaruar në kontratë.

### **Seksioni “Çmimi”**

Për shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara kundrejt pagesës së drejtëpërdrejtë monetare, ky seksion do të përfshijë çmimet për aktivizimin e shërbimit dhe tarifat periodike të pajtimit ose të lidhura me konsumin.

Për kontratat e pajtimit, përfshihet tarifa periodike, përfshirë taksat, për periudhën e faturimit dhe, nëse periudha e faturimit është e ndryshme nga mujore, përfshihet edhe tarifa në bazë mujore. Këtu përfshihen dhe çdo tarifë shtesë fikse, siç është për aktivizimin e shërbimit, dhe, kur është e aplikueshme, duhet të tregohet dhe çmimi i pajisjes fundore, si dhe çdo zbritje e kufizuar në kohë në pajtimin mujor.

Në përmbledhjen e kontratës përfshihen, kur janë të aplikueshme, dhe tarifat e lidhura me sasinë e konsumuar të tilla si tarifat për njësi konsumi, të cilat aplikohen në rastet kur tejkalohen volumet/njësitë e shërbimeve të përfshira në tarifën periodike. Kur është e aplikueshme, informacioni për tarifat për shërbime shtesë që nuk përfshihen në tarifat periodike, sqarohet se ky informacion është i disponueshëm në një dokument/mjet të veçantë.

Nëse shërbimi ofrohet pa një pagesë të drejtëpërdrejtë monetare, por që i nënshtrohet detyrimeve të caktuara për përdoruesit si kusht për ofrimin e shërbimit, kjo do të tregohet në mënyrë të qartë në këtë seksion.

### **Seksioni “Kohëzgjatja, rinovimi dhe përfundimi i kontratës”**

Në këtë seksion përfshihet informacioni mbi kohëzgjatjen e kontratës i shprehur në muaj dhe kushtet kryesore për rinovimin dhe përfundimin e saj për shkak të përfundimit të afatit të caktuar të kontratës dhe për shkat të përfundimit para afatit të caktuar të kontratës, kur është e aplikueshme. Në këtë seksion përfshihen dhe penalitetet për përfundimin para afatit të caktuar të kontratës, përfshirë informacionin për zhblokimin e pajisjeve terminale, nëse janë të aplikueshme. Ky informacion jepet pa cënuar apo përjashtuar rastet e tjera për përfundimin e kontratës sipas legjislacionit në fuqi, siç është në rast të mungesës së përmbushjes së kushteve të kontratës.

## **Seksioni “Funksionalite për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara”**

Në këtë seksion paraqitet informacion në lidhje me produktet dhe shërbimet kryesore që ofrohen për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, të cilat mund të përfshijnë, kur janë të disponueshme, të paktën tekst në kohë reale (real-time text), bisedë totale (total conversation), shërbime me asistencë të operatorit (relay services), shërbime të aksesueshme të emergjencës, pajisje të specializuara, tarifa speciale dhe informacion i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuar. Në lidhje me detajet për këto shërbime, kur janë të aplikueshme, mund të vendoset një shënim se ato mund të vihen në dispozicion të përdoruesit me mjete/mënyra të veçanta.

## **Seksioni “Informacion tjetër i rëndësishëm”**

Në këtë seksion ofruesi i shërbimit mund të përfshijë informacion shtesë të kërkuar nga legjislacioni kombëtar (Ligji 54/2024 dhe/ose Ligji 9902/2008) për t’ju ofruar konsumatorit para lidhjes së një kontratë apo pranimit të një oferte.

## **SHËNIME**

### **Raste përjashtimore objektivisht të justifikuara**

Raste objektivisht të justifikuara kur mund të tejkalohet numri maksimal i faqeve (1 ose 3 në rastin e paketave të shërbimeve) të përmbledhjes së kontratës të referuar në pikën 1 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje, konsiderohen rastet kur dokumenti i përmbledhjes së kontratës ofrohet në një format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuar si p.sh në format Large Print ose Braille.

Raste objektivisht të justifikuara kur mund të reduktohet madhësia e shkrimit (në krahasim me minimumi 10 pikë) të përmbledhjes së kontratës të referuar në pikën 2 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje, konsiderohen rastet kur përmbledhja e kontratës duhet të përshtatet në madhësi për t’u përfshirë në paketimin kartave SIM me parapagim të shitura në pikat e shitjes së operatorëve, ku përdorimi i madhësisë 10 pikë nuk do të ishte praktik. Megjithatë, në të tilla raste duhet të ofrohet mundësia që përmbledhja e kontratës me kërkesë të konsumatorit të merret në format me madhësi teksti jo më pak se 10 pikë

### **Sqarime të tjera**

Objektet vizuale të referuara në pikën 3 të Nenit 4, të kësaj Rregulloreje i referohen simboleve, ikonave dhe grafikëve apo përdorimit të “hyperlink”-eve apo “pop-up”,

Në seksionin e Përshkrimit të Shërbimit, volumi ose sasia e thirrjeve, mesazheve dhe të dhënave të përfshira në planin tarifor përkatës. kur është e aplikueshme, duhet të jepën në minuta, numër SMS dhe MB ose GB sipas rastit, duke përfshirë dhe përshkrim për politikën e përdorimit të drejtë në roaming në Ballkanin Perëndimor të aplikuar nga ofruesi i shërbimit (celular) dhe sasinë e të dhënave (MB/GB) pa kosto ekstra në roaming në BP, e llogaritur në përputhje me “*Rregullore mbi Zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor*”, miratuar me VKD të AKEP me Nr.9, datë 9.06.2021.



# Shtojca 1: Shpjegues për Dokumentin për Këshillim Publik

## Baza ligjore për nxjerrjen e aktit

Ligji 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar Ligjin 9918/2008. Ligji 54/2024 transpozon në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim EECC), dhe përmban një sërë përcaktimesh të reja në lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, një pjesë e të cilave përbëjnë risi për tregun e komunikimeve elektronike dhe zbatimi i tyre nga ofruesit e shërbimeve duhet të kryhet në përputhje me aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP për zbatimin e ligjit të ri.

Neni 141 i Ligjit 54/2024 përmban detyrime për ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshme për publikun në lidhje me informacionin që ata duhet të ofrojnë/vënë në dispozicion për konsumatorët para lidhjes së kontratës apo pranimit prej tyre të një oferte korresponduese. Informacioni para-kontraktual i ofruar konsumatorëve duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit (9902/2008) si dhe sipas nenit 180 të ligjit 54/2024, i cili përcakton informacionin që duhet të përmbajnë kontratat e lidhura me konsumatorët. Detyrimet ligjore për ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshme për publikun për ofrimin e informacionit parakontraktual përfshijnë dhe detyrimin për vënien në dispozicion të konsumatorëve të përmbledhjes së kontratës.

Sipas pikës 5 të Nenit 141 të Ligjit 54/2024:

*Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, duhet t'u vënë në dispozicion konsumatorëve një përmbledhje të shkurtër dhe lehtësisht të lexueshme të kontratës. Kjo përmbledhje duhet të identifikojë elementet kryesore të kërkesave të informacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, ku përfshihen të paktën:*

- a) emri, adresa dhe detaje të kontaktit të ofruesit dhe, nëse është i ndryshëm, dhe detajet e kontaktit për ankesat;*
- b) karakteristikat kryesore të secilit shërbim të ofruar;*
- c) çmimet përkatëse për aktivizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike, përfshirë të gjitha tarifatat fikse periodike ose në bazë të konsumit të njësisive, kur shërbimi ofrohet kundrejt pagesës direkte monetare;*
- ç) kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e saj;*
- d) masa në të cilën produktet dhe shërbimet janë të projektuara për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara;*
- dh) në lidhje me shërbimet e aksesit në internet, një përmbledhje të informacionit të kërkuar, sipas shkronjave “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 178 të këtij ligji.*

Përmbledhja e kontratës është një informacion para-kontraktual (dokument që ofruesi duhet të vendosë në dispozicion të konsumatorit para lidhjes së kontratës apo pranimit të një oferte korresponduese), por që pas lidhjes së kontratës, ajo bëhet pjesë e dokumentacionit të marrdhenies kontraktore midis ofruesit të shërbimit dhe konsumatorit që ka lidhur kontratën/pranuar ofertën korresponduese (pika 7 e nenit 141).

Sipas pikës 6 të nenit 141:

*Ofruesit e shërbimit, që janë objekt i zbatimit të detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, plotësojnë në mënyrën e duhur modelin përmbledhës të kontratës me informacionin e kërkuar, në përputhje me rregulloren e miratuar nga AKEP-i dhe pajisin konsumatorin me përmbledhjen e kontratës, pa pagesë dhe përpara lidhjes së kontratës, përfshirë për kontratat në largësi. Kur për arsye objektive teknike është e pamundur të sigurohet përmbledhja e kontratës në atë moment, ajo duhet të sigurohet më pas dhe pa vonesa të panevojshme dhe kontrata bëhet efektive kur konsumatori pas marrjes së përmbledhjes së kontratës konfirmon dakordësinë e tij.*

### **Modeli i përmbledhjes së kontratës:**

Në përputhje me përcaktimet e mësipërme të pikës 6, të nenit 141 të Ligjit 54/2024, AKEP ka hartuar këtë dokument të draft-Rregullores për “Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, për këshillim publik me palët e interesuara.

AKEP, në përputhje me pikën 4 të Nenit 10 të Ligjit 54/2024, në përgatitjen e dokumentit të draft-Rregullores për “Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, është bazuar në Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243,<sup>2</sup> e cila është miratuar nga KE më datë 17.12.2019, në zbatim të nenit 102 (pika 3) të EECC. Me miratimin e versionit final të draft-rregullores për “Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, synohet gjithashtu transpozitimi i plotë i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243, e parashikuar si angazhim i AKEP dhe në PKIE 2022-2024.

Dokumenti i draft-Rregullores për “Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” është i strukturuar si më poshtë vijon:

- Pjesa Kryesore:
  - Nenet 1-2: Qëllimin dhe fushën e veprimit të Draft-Rregullores si dhe Përkufizime, përfshirë për përdoruesit fundorë që janë ndërmarrje mikro ose të vogla ose organizata jofitimprurëse, sipas legjislacionit në fuqi;
  - Nenet 3-4: Rregullat për modelin që do përdoret dhe për prezantimin e përmbajtjes së përmbledhjes së kontratës
- (Hartuar në përputhje të plote me Nenet 1 dhe 2 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243);
- Aneks 1: Modeli i përmbledhjes së kontratës
- (Hartuar në përputhje të plote me Pjesën A të Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243)
- Aneks 2: Udhëzime për plotësimin e përmbledhjes së kontratës dhe Shënime

---

<sup>2</sup> Rregullore Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/2243 e datës 17 dhjetor 2019 që përcakton një model për përmbledhjen e kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun në përputhje me Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

*(Udhëzimet për plotësimin e përmbledhjes janë Hartuar ne perputhje te plote me Pjesën B të Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243:*

*Pjesa Shënime përmban disa sqarime sipas përcaktimeve të pjesës hyrëse të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243).*

### **E drejta për t'u pajisur me përmbledhje të kontratës (kategoritë e përdoruesve fundorë):**

Përcaktimet në pikat 1, 2, 3, 5, dhe 6 të Nenit 141 si edhe në pjesë të tjera të Kreut XVIII (Të Drejtat e Përdoruesit Fundor) të Ligjit 54/2024, i referohen të drejtave të konsumatorëve apo detyrimeve për ofruesit e shërbimeve në raport me konsumatorin, si kategori e përdoruesve fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Megjithatë, sipas preambulës nr.259 të EECC, nga këto të drejta duhet të përfitojnë dhe përdorues fundorë të këyre shërbimeve që janë mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse të përcaktuara sipas legjislacionit kombëtar, pasi fuqia negociuese e këtyre kategorive të përdoruesve fundorë është e krahasueshme me atë të konsumatorëve dhe prandaj ata kanë nevojë për të njëjtin nivel mbrojtje, përveç rasteve kur këta përdorues japin pëlqimin e shprehur se heqin dorë nga këto të drejta.

Sipas pikës 4 të Nenit 141 të Ligjit 54/2024, *Informacioni i referuar në pikat 1 dhe 5 të këtij neni duhet t'u jepet gjithashtu përdoruesve fundorë, që janë ndërmarrje mikro ose të vogla ose organizata jofitimprurëse, përveç rasteve kur këta përdorues japin pëlqimin e shprehur se heqin dorë nga të gjitha ose një pjesë e të drejtave të përfshira në këto dispozita.* Në këto kushte, detyrimi i ofruesve të shërbimeve për përmbledhjen e kontratës është i zbatueshëm dhe për përdoruesit fundorë të këtyre shërbimeve që janë të kategorisë biznes por që sipas legjislacionit në fuqi në RSH janë të regjistruar/klasifikuar si **mikrondërmarrje ose ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse**. Legjislacioni në fuqi në RSH për ndërmarrjet mikro dhe të vogla dhe organizatat jofitimprurëse përfshin:

- Ligj nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”
- Ligj nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”
- Ligj Nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar.

### **Detyrimi për ofrim të përmbledhjes së kontratës (kategoritë e sipërmarrësve):**

Ligji 54/2024 përmban përkufizime/kategorizime të reja për ofruesit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike në krahasim me ligjin 9918/2008 dhe detyrimet ligjore ndryshojnë sipas kategorisë së ofruesit të shërbimeve/rrjeteve. Për sa i përket detyrimit për ofrimin e përmbledhjes së kontratës, neni 141 në pikat 1 dhe 5, përcakton që ky detyrim aplikohet për *ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë.*

Pra detyrimi për të ofruar dokumentin e përmbledhjes së kontratës aplikohet ndaj të gjithë sipërmarrësve që ofrojnë shërbim të aksesit në internet, komunikimit ndërpersonal (si shërbime të komunikimit zonor/shërbim publik telefonik) etj., nëpërmjet rrjeteve fikse ose rrjeteve celulare.

### **Lidhja me akte të tjera nënligjore**

Përmbledhja e kontratës është një dokument me informacion përmbledhës parakontraktor dhe nuk zëvendëson informacionin e plotë parakontraktor që ofruesi i shërbimit ka detyrim të vendosë në dispozicion të konsumatorit dhe as kontratën që do lidhë me konsumatorin. Dokumenti i

përmbledhjes së kontratës shërben për pajisjen e konsumatorit me informacion të rëndësishëm dhe të përmbledhur para lidhjes së kontratës, në mënyrë që konsumatori të jetë i mirë-informuar për elementët kryesorë të shërbimit si përshkrimi i shërbimit, cmimi, kohëzgjatja e kontratës dhe penaliteti për ndërprerje para afatit të kontratës, shpejtësitë e aksesit në internet (minimale, maksimale dhe normalisht e disponueshme etj.), detaje të kontaktit të ofruesit të shërbimit për ankesa dhe zgjidhje mosmarrevshje me konsumatorët etj.. Ky informacion thelbësor i paraqitur në mënyrë konsistente për të gjitha shërbimet/paketat e ofruara nga i njëjti ofrues shërbimi dhe nga të gjithë ofruesit e shërbimeve në treg, sipas modelit të përmbledhjes së kontratës dhe udhëzimeve të përcaktuara në këtë draft-Rregullore lehtëson procesin e krahasimit nga konsumatorët të shërbimeve/paketave tarifore të njëjtit ofrues shërbimi dhe ofruesve të tjerë si dhe redukton kostot e zbatimit të këtij detyrimi ligjor për ofruesit e shërbimeve.

Nëpërmjet miratimit të versionit final pas këshillimit publik të draft-Rregullores për *“Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*, plotësohet kuadri nënligjor për përmbledhjen e kontratës i përcaktuar në pikat 5 dhe 6 të nenit 141 të Ligjit 54/2024. Ndërkohë, përcaktimet kryesore të pikave 1-3 të Nenit 141 të Ligjit 54/2024, janë aktualisht pjesë e Rregullores 49/2021 (neni 9), e cila do të jetë objekt rishikimi nga AKEP në muajt në vijim në kuadër të përgatitjes së kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e konsumatorit për përputhshmëri të plotë me Ligjin 54/2024 (Neni 141, 180 dhe gjithë përcaktimet e tjera të lidhura me mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit fundor).

Në procesin e përgatitjes së kuadrit të ri rregullator për zbatimin e përcaktimeve të neneve 177-179 (Garantimi i aksesit të hapur në Internet) të Ligjit 54/2024, AKEP do të nxjerrë dhe një dokument Udhëzues (brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit 54/2024), ku do të jepen dhe përcaktime dhe shpjegime në lidhje me shpejtësitë e internetit (minimale, maksimale, normalisht e disponueshme etj.) në rrjete fikse dhe celulare si dhe për mekanizmin monitorues të cilësisë/shpejtësisë së Internetit, të certifikuar nga AKEP-i, për të vertetuar mospërputhjet e vazhdueshme të shpejtësive të aksesit në internet (aktuale v. kontratë), të cilat janë të zbatueshme vetëm për kontratat e lidhura pas datës 20.12.2025.

## **Pyetjet e këshillimit publik**

### **Cështje 1: Modeli i Përmbledhjes së Kontratës**

Qëllimi kryesor i përcaktimit të modelit të përmbledhjes së kontratës është që të gjithë sipërmarrësit të përdorin një model të standardizuar të Përmbledhjes së Kontratës, i cili do t’i shërbejë sa më mirë lehtësimit të krahasimit nga konsumatori të ofertave/shërbimeve të njëjtit operator ose midis operatorëve të ndryshëm.

AKEP ka hartuar këtë draft-rregullore bazuar në Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243. Aneksi 1 paraqet modelin e Përmbledhjes së Kontratës sipas Pjesës A të Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243, ku janë dhënë Titujt/seksionet Kryesore të Përmbledhjes së Kontratës, por pa vendosur detyrim për paraqitje të informacionit në mënyrë

tabelare dhe pa specifikuar Nëntituj/nën-seksione brenda Titujve/seksioneve kryesore, duke lejuar fleksibilitet për ofruesit shërbimeve.

**Pyetje 1:** *A mendoni se AKEP duhet të përcaktojë kërkesa shtesë, krahasuar me modelin e përcaktuar në Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243, në lidhje me Modelin e Përmbledhjes së Kontratës në Aneksin 1, duke përfshirë detyrimin për paraqitje të informacionit në formë tabelare dhe/ose duke shtuar nëntituj/nënseksione sipas Sqarimeve në Aneks nr.2?*

## **Cështja 2: Afati i hyrjes në fuqi/zbatimit të detyrimit nga ofruesit e shërbimeve të Përmbledhjes së Kontratës**

Në kushtet që shërbimi i aksesit në internet në rrjete fikse dhe celulare është bërë tashmë shërbimi më i rëndësishëm i komunikimeve elektronike publike për përdoruesit fundorë (pothuajse të gjitha ofertat e shërbimeve të rrjeteve celulare dhe fikse përmbajnë shërbimin e aksesit në internet), dhe cilësia e shërbimit të aksesit në internet ka një focus të shtuar në ligjin 54/2024 (përcaktimet në nenet 143 dhe 177-179), AKEP ka propozuar që data e hyrjes në fuqi të Rregullores (version final pas këshillimit publik i miratuar nga KD i AKEP) të jetë më datë 20.12.2025, që përkon dhe me afatin e referuar në pikën 3 të nenit 178:

*Çdo mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht, midis cilësisë aktuale të shërbimit të aksesit në internet, në lidhje me shpejtësinë ose parametrat e tjerë të cilësisë së shërbimit dhe performancës së treguar nga ofruesi i shërbimeve të aksesit në internet, në përputhje me shkronjat “a” deri në “d” të pikës 1 të këtij neni, **kur faktet përkatëse vërtetohen nga një mekanizëm monitorues, i certifikuar nga AKEP-i, konsiderohet se përbën mospërputhje të performancës për qëllime të nxitjes së mjeteve juridike të disponueshme për konsumatorin, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Ky paragraf zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ose të rinovuara 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.***

Pra, të gjithë sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike publike (shërbim aksesi në internet, komunikim ndërpersonale etj) nëpërmjet rrjeteve fikse dhe/ose celulare, përfshirë për paketat e këtyre shërbimeve që përmbajnë dhe pajisje fundore apo shërbime TV (IPTV ose TV kabllor) do kene detyrimin që duke filluar nga data 20.12.2025 të vendosin në dispozicion të përdoruesve fundorë (të kategorisë konsumatorë dhe të kategorisë mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse sipas përcaktimeve në Rregullore) dokumentin e Përmbledhjes së Kontratës për kontratat e lidhura ose të rinovuara prej datës 20.12.2025 e në vijim.

**Pyetje 2:** *A jeni dakord me afatin e propozuar nga AKEP për hyrjen në fuqi të Rregullores/datën e fillimit të zbatimit nga operatorët të detyrimeve të kësaj Rregulloreje?*

Përvec pyetjeve të mësipërme, AKEP mirëpret komente dhe sugjerime me shkrim për çdo aspekt tjetër të dokumentit dhe propozimeve në këtë draft-Rregullore.

Në përgjigjet e dhëna për pyetjet, palët rekomandohet të përfshijnë edhe argumentim për përgjigjet/komentet si dhe sugjerime për përmirësimin e dokumentit.

Procesi i këshillimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP, dhe palët e interesuara mund të dërgojnë komentet me shkrim në AKEP si më poshtë:

- në formë shkresore në adresën Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë.
- në formë elektronike me email në adresën [info@akep.al](mailto:info@akep.al).